

LIGJ
Nr.8413, datë 1.10.1998

**PËR RATIFIKIM E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË TË REPUBLIKËS TË SLLOVENISË PËR BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR
TERRORIZMIT, TRAFIKUT TË PALIGJSHËM TË DROGËS DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe të nenit 17 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Sllovenisë për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, trafikut të paligjshëm të drogës dhe krimit të organizuar".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.2233, datë 15.10.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARREVESHJE

Midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë , mbi bashkepunimin në luftën kundër terrorizmit, trafikut të paligjshëm të drogës dhe krimit të organizuar.

Qeveria e Republikës së Sllovenisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë (të quajtura palë kontraktuese) kanë bashkevendosur:

- Të kontribuojnë në zhvillimin e kontakteve bilaterale.
- Të bashkëpunojnë në fushën e parandalimit të krimit, veçanërisht të krimit të organizuar dhe trafikut të paligjshëm të drogës, e luftës kundër terrorizmit, dhe parandalimit të tij të suksesshem.
- Të rritin përpjekjet e përbashkëta në luftën kundër terrorizmit dhe abuzimit të drogës.
- Të harmonizojnë veprimet e tyre kundër krimit të organizuar dhe marrjen në konsideratë të marrveshjeve ndërkombëtare për punën në këto fusha.

U KONKLUDUA KJO MARREVESHJE :

Neni 1

1. Duke marrë në konsideratë legjislacionet përkatëse të shteteve, palët kontraktuese do të koeporojnë në parandalimin e terrorizmit, trafikut të paligjshëm të drogës, dhe krimit të organizuar, në zbulimin dhe denimin e formave të tilla të krimit, gjithëashtu

ne parandalimin, zbulimin dhe denimin e formave te tjera te krimit.

2. Palet kontraktuese do të bashkeveprojnë veçanarisht në rastet kur aktet kriminale ose përgatitjet e tyre janë kryer ne teritorin e njëres palë nga palët kontraktuese, dhe kur te dhenat drejtohen ne teritorin e palës tjetër kontraktuese.

Neni 2

Palet kontraktuese do te bashkepunojne ne zbulimin dhe parandalimin e krimit, veçanarisht te krimit te organizuar dhe do të:

1. Bëjnë te ditur njeri-tjetrit te gjitha te dhenat mbi persona të perfshire ne krimin e organizuar, te dhena mbi lidhjet ndermjet kriminelëve, informacionin mbi organizatat dhe grupet kriminale, per sjelljen tipike te krimineleve, per faktet duke i kushtuar kujdes të veçante kohes e vendit, mënyrës së kryerjes së akteve kriminale, objekteve të sulmeve te tyre, te kushteve, te neneve te kodeve penale, te cilat jane shkelur dhe masat e marra nëse eshte e domosdoshme ne aste te caktuara, per te parandaluar disa akte kriminale te rrezikëshme.

2. Kryen veprime policore te caktuara sipas kerkeses dhe ne perputhje me legjislacionin e vlefshem te palës se kerkuar kontraktuese.

3. Bashkepunon ne hetimet ne perputhje me marreveshjen aktuale, legjislacionet e shteteve kontraktuese , dhe me një marrëveshje të vlefshme ndërmjet palëve kontraktuese për ekstradimin dhe ndih-

men ligjore lidhur me aktet kriminale dhe me njohjen e masave polici-
core së bashku me ndihmen per kuadrin, ndihmen materiale dh organi-
zative.

4. Shkembimi i te dhenave dhe i korespondences mbi metodat dhe
format e reja të përdorura nga kriminelet në krimin nderkombëtar.

5. Shkembimi i rezultateve të hetimeve kriminalistike, krimi-
nologjike dhe hetimeve të tyre të tjera të akteve kriminale, infor-
mojnë njëri-tjetrin mbi menyrën e hetimit të veprimeve kriminale,
sikurse dhe përdorimin e metodave dhe mjeteve ne punen e tyre, me
qëllim që t'i zhvillojme me tej ato.

6. Shkëmbimi sipas kërkesës i tër informacionit ose pjes të
objekteve që jane rezultat i nje akti kriminal dhe të objekteve te
përdorura ne kryerjen e veprave (akteve) kriminale.

7. Shkëmbimi i ekspertëve per permirsimin e perbashket dhe dy-
palësh cilësore si pjesë e luftes kunder krimit te organizuar, in-
kurajon mundesitë per arsimimin e metejshem te specialistëve të
tyre me qëllim qe te arrinë një shkalle me te larte ne njohurit
profesionale, per kuptimin dypalësh (te perbashket) te mjeteve
dhe metodave te luftes kunder krimit dhe rezultatet bashkëkohore te
teknikave te policise kriminale.

8. Në qofte se eshte e nevojshme ne hetime te caktuara do te
organizojnë takime pune lidhur me pergatitjet dhe zbatimin e masave
te marra.

Neni 3

Për parandalimin e kultivimit, prodhimit, eksportimit dhe importit, kalimit të paligjshëm të drogës, lëndët psikoterapike dhe të lartepërmendura sikurse edhe trafikimi i paligjshëm i këtyre substancave, palët kontraktuese lidhur me legjislacionin e të dy Shteteve do të :

1. Do t'i dergojnë njëra-tjetres të gjitha të dhënat e personave të përfshirë në prodhimin dhe trafikimin e drogës, për mënyrat dhe mjetet e fshehjes dhe transportimit dhe mënyrën e veprimit, për vendet ku kanë origjinën dhe destinacionin e drogave dhe të gjitha hollësitë e tjera të veçanta për veprimet kriminale, nëse është e nevojshme për parandalimin e krimit ose në raste të caktuara për parandalimin e veprave të dhunshme kriminale ndaj rendit publik.

2. Shkëmbimi i të dhënave për rruget (mënyrat) e zakonshme dhe të reja të trafikimit ndërkombëtar të paligjshëm të drogës dhe të gjitha informacionet e tjera lidhur me të.

3. Shkëmbimi i rezultateve të krimit dhe hetimet krimnologjike të trafikimit të drogës dhe abuzimet e saj.

4. Shkëmbimi i mostrave të drogave të reja me origjinë sintetike dhe vegjetale dhe të lëndëve psikotropike.

5. Shkëmbimi i eksperiencës së tyre për kontrollin e përdorimit (mbajtjes) të paligjshëm të drogës, të substancave psikotropike dhe të atyre të lartepërmendura nga pikpamja e mundësive të trafikimit të paligjshëm të substancave të tilla.

6. Paët kontraktuese do te harmonizojne masat policore te lejuara me ligje, per parandalimin e prodhimit te paligjeshem te drogave dhe lendeve psikotropike.

Neni 4

Me gellim qe te parandalohen aktet e terroristeve, palet kontraktuese sipas legjislacionit te tyre te vlefshem dhe duke marre parasysh marrveshjen e tanishme do te veprojne si me poshte:

1. Shkëmbimi i njohurive dhe te dhenave mbi veprimet terroriste te planifikuara dhe te kryera, persanave te perfshire, menyrave te zbatimit dhe te mjeteve teknike te perdorura ne veprime te tilla.

2. Shkëmbimi i njohurive te tyre dhe te dhenave mbi grupet terroriste, anëtarët e tyre te cilet planifikojne dhe kryejne veprat e tyre kriminale ne teritorin e njerës nga palet kontraktuese, ne kundërshtim me interesat e ketij vendi, informacion te tille te dobishem per te ndaluar terrorizmin dhe parandalimin e akteve te dhunshme kriminale.

Neni 5

Bashkepunimi ndermjet palve kontraktuese perfshin gjithëashtu:

1. Shkëmbimin e te gjithë informacionit lidhur me legjislacionin qe trajton aktet kriminale te perfshira ne marrveshjen aktuale

2. Shkëmbimi i informacionit per perfitimet qe dikush arrin ne saj te veprimtarise kriminale.

3. Shkëmbimi i legjislacionit dhe eksperiences lidhur me te huajt ose emigrimin.

4. Shkëmbimi i te gjitha pjesve te informacionit te cilat jane te rëndesishme per njerën nge palet kontraktuese ne luftën kunder kontrabandes se njerzve dhe trafikimit te paligjeshem te punetorve.

Neni 6

1. Autoritetet kompetente te paleve kontraktuese:

Per Republikën e Shqiperise - Ministri i Rendit Publik.

Per Republikën e Sllovenise - Ministri i Brendeshem ,Ministri i Financave dhe Ministri i Shendetesise.

-Duhet te kene nje bashkepunim direkt dhe bashkepunim pune ne fushat perkatese te punes se tyre dhe kompetence per zbatimin e marrveshjes aktuale dhe do te percaktojne fushat konkrete te punes dhe format e bashkepunimit me protokoll (Proçes - verbal).

2. Shkëmbimi i informacionit ndermjet perfaqsesve te autoriteteve pjesmarrese do te behet ne gjuhen Angleze, ne se bien ne dakord palet.

Neni 7

Kushtet e meposhteme per mbajtjen e te dhenave mbi personat,

te cilat shkembihen ndermjet paleve kontraktuese ne kuadrin e bashkepunimit, do te qendrojne duke patur parasyshe legjislacionin e vlefshem te shteteve kontraktuese.

1. Pala kontraktuese qe merre keto te dhena mund t' i perdore ato vetem per qellimet e percaktuara nga pala kontraktuese e cila i ka derguar ate dhe ka percaktuar ne te njejten kohe kushtet per perdorimin e tyre.

2. Pala kontraktuese e cila merre te dhena te tilla sipas kerkeses se pales kontraktuese - derguese do te informoje kete te fundit per perdorimin e te dhenave te tilla dhe rezultatet e arritura me to.

3. Te dhenat lidhur me persona te ndryshem, mund ti jepen vetem autoriteteve kompetente ose organizatave qe merren me parandalimin e krimit, dhe autoriteteve kompetente per luften kunder terrorizmit, droges dhe krimit te organizuar. Nje dorzim i te dhenave te tilla autoriteteve te tjera eshte i mundeshem vetem me miratimin paraprak me shkrim te pales tjeter kontraktuese qe ka derguar te dhena te tilla.

4. Pala kontraktuese qe ka derguar te dhenat e kerkuara duhet te kontrolloje vertetesine e te dhenave, po keshtu n.q.s. dorzimi i te dhenave eshte i nevojshem dhe n.q.s. eshte bere ne raport me nevojshmerine, duhet te merret parasyshe gjithashtu legjislacioni i te dhenave ne perputhje me ligjeshmerin e tij kombetare. Ne se provohet qe te dhenat fallso ose te dhenat, te cilat nuk do te kene gene dorzuar i njoftohen pales tjeter kontraktuese qe merre te

dhene te tilla, duhet te informohet per kete fakte menjehere. Pala kontraktuese ,e cila merre te dhena te tilla duhet te sakesoj te dhenat jo te sakta (qe nuk jane te verteta) dhe te zhduke menjeher te dhenat qe u jane dhene gabimisht ose qe nuk duhej ti kishin marre.

5. Me kerkesen e personit qe ka interes per te gjitha te dhenat, ketij personi duhet t' i spjegohet edhe perdorimi i mundeshem i ketyre te dhenave. N.q.s. nuk specifikohet ne legjislacionin ekzistues spjegime te tilla nuk jane te detyrueshme. Legjislacioni i vevojshem i pales kontraktuese qe jep te dhena te tilla duhet te merret ne konsiderate kur jepen spjegime te tilla.

6. Pala kontraktuese qe jepe te dhena ne perputhje me legjislacionin e saj, duhet te vendose per dorzimin gjithashtu te kushteve te vlefshme te marrveshjes per zhdukjen e te dhenave te tilla. Pamvarsishte nga te dhenat e fundit te gjitha te dhenat lidhur me nje person te caktuar duhet te zhduken, kur ato nuk konsiderohen me te vlefshme. Pala kontraktuese qe dergon te dhena te tilla duhet te informohet per zhdukjen e te dhenave te tilla dhe per arsyet e zhdukjes se tyre. Te gjitha te dhenat e marra duhet te zhduken sapo te perfundoj marrveshja aktuale.

7. Palet kontraktuese jane te detyruara te rregjistrojne te gjitha informacionet qe dergohen (dorzohen) ose te dhenat mbi personat qe zhduken.

8. Palet kontraktuese mund te parashikojne ruajtjen e te dhenave personale, parandalimin dhe nderprerjen e personave te pa

autorizuar per te dhene te dhena te tilla, ndryshimin e tyre, dhe mos lejimin e publikimit te tyre.

Neni 8

1. Palet kontraktuese do te garantojne fshehtesen e ndonje te dhene te tille qe eshte vlersuar ose dhene ne mirbesim nga nje pale kontraktuese dhe n.q.s. ato percaktohen si sekret nga rregulloret ekzistuese te shtetit qe bene dorzimin e tyre.

2. Dergimi i materialit, qe eshte dorzuar ne perputhje me marrveshjen aktuale duke dhene te dhenat dhe paisjet teknike ndonje shteti te trete eshte i mundeshem vetem ne baze te nje miratimi me shkrim te nje autoriteti kompetent te pales kontraktuese qe i jep ato.

Neni 9

1. Palet kontraktuese do te formojne nje komitet pune miks per vlersimin dhe ngritjen ne nje shkalle me te larte te bashkepunimit ne baze te marrveshjes aktuale. Palet kontraktuese do te informojne njeri - tjetrin me ane te korjerit diplomatikë qe ben pjese ne nje komitet te tillë.

2. Komiteti miks i furmuar duhet te kete te pakten nje sesion çdo vit. Ndonje nga palet kontraktuese mund te sugjeroje ne se eshte e nevojshme takime te tjera shtese per kete komitet. Keto

misione te komitetit do te mbahen ne menyre alternative ne Republiken e Shqiperise dhe Republiken e Sllovenise.

Neni 10

Çdo pale kontraktuese ka te drejt te refuzoje pjeserisht ose plotesisht bashkepunimin ose mbeshtetjen ose te vendosin kushte te caktuara n.q.s kete do te kufizonte legjislacionin kombetare, do te rrezikonte sigurin e Shtetit ose interesa te tjera te rendesishme, ose shkeljen e rregullave ligjore kombetare te saj.

Neni 11

Palet kontraktuese autorizojne Ministrin e Brendeshem Slloven dhe Ministrin e Rendit Publik Shqiptare te zgjedhin personat qe do te mbajne kontakt me autoritetet kompetente te pales tjeter kontraktuese.

Neni 12

Paragrafet (nenet) e marrveshjes aktuale nuk zbatohen ne marrveshjet nderkombetare dy paleshe dhe shumepaleshe te nenshkruara nga Qeverite e Republikes se Sllovenise dhe Republikes se Shqiperise.

Neni 13

1. Marrveshja konkrete aktuale do te ratifikohet. Do te bëhet e vlefshme dhe efektive ne ditën e 30 te shkembimit reciprok te notave diplomatike te ratifikimit te marrveshjes aktuale.

2. Kjo marrveshje u nënshkrua per nje kohe te pacaktuar. Ndonjera nga palet kontraktuese mund te heq dore nga marrveshja ne rruge diplomatike. Dorheqja behet efektive 6 muaj qe nga dita qe pala tjeter kontraktuese merr nje note te tille.

Nenshkruar ne Tirane, më 24 .septor. 1993 ne dy gjuhët origjinale Sllovene dhe Shqipe, duke qënë sejcili tekst i njejte ne gjuhët autentike perkatese.

Per Qeverin e Republikës

SHQIPTARE

Ministri i Rendit Publik

AGRON MUSARAJ



Per Qeverin e Republikës

SLLOVENE

Ministri i Brendeshem

IVAN BIZJAK

